



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 27 janar 2010
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë anëtarët e Komisionit: Rustem Mustafa, Eqrem Kryeziu, Shkumbin Demaliaj, Zylfi Merxha dhe Lulzim Zeneli.

Munguan: Suzana Novoberdaliu, Zafir Berisha, Melihate Termkolli dhe Bojan Stojanoviq.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Blerina Pula dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23. 12. 2009,
3. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2010,
5. Shqyrtimi i Planit të veprimit nga Raporti i progresit,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 23. 12. 2009

Procesverbali i 23. 12. 2009 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës për vitin 2009

Kryetari i Komisionit – Tha se para vetes keni Raportin e punës për vitin 2009, ku janë të paraqitura në mënyrë kronologjike të gjitha aktivitetet e Komisionit. Para se ta miratojmë, nëse ka dikush vërejtje le të urdhërojë.

Anëtarët e Komisionit miratuan Raportin e punës për vitin 2009.

4. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2010

Kryetari i Komisionit – Tha se kemi hartuar një Draftplan të punës me aktivitete të mundshme të Komisionit për vitin 2010. Ju e dini se Plani i punës asnjëherë nuk është përfundimtar, por mund të plotësohet kohë pas kohë. Ky draftplan është i bazuar edhe në strategjinë legislative të Qeverisë për vitin 2010.

Eqrem Kryeziu - Unë mendoj se materia është shpërndarë në mënyrë të baraspeshuar gjatë vitit, kështu që ky plan i punës për vitin 2010, siç thatë edhe ju, mund të ndryshohet. Sa më përket mua është krejt i pranueshëm.

Anëtarët e Komisionit miratuan Planin e punës për vitin 2010.

5. Shqyrtimi i Planit të veprimit nga Raporti i progresit

Kryetari i Komisionit - Ne, si Komision, e kemi në shqyrtim Planin e progresit dhe do të caktojmë një referues për shqyrtimin e planit. Unë kam menduar që, si referues, ta caktoj Shkumbin Demaliajn. Ju e dini që ne kemi si pikë komunikuese MPB - në dhe agjencionet e tjera.

Shkumbin Demaliaj – Mendoj se do të duhet pak kohë për të punuar bashkë me stafin në lidhje me pikat kyçe në këtë raport. Kjo pikë njoftimi duhet të jetë edhe në mbledhjen e ardhshme, kur pjesëmarrja e deputetëve të jetë më e madhe. Këto kërkesa të Raportit të progresit neve na imponohen, jo që ne dëshirojmë. Për këtë arsye ne duhet të fokusohemi më gjerësisht.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Kjo është mbledhja e parë e Komisionit për këtë vit. Ju ftoj që të gjithë, si anëtarë të Komisionit, të angazhohemi për kontribut në punën e Komisionit. Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë, i formuar më herët nuk ka funksionuar. Në muajin shkurt do të formohet një grup punues me përbërje tjetër dhe do të fillohet me vizitat për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Pasi që nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa